

# V"-në se ka e nxënësve




lëshuar nga  
one se këto 2  
i njëjti autor.  
ndërrhyrje e  
tën paraelek-  
açanikut dhe  
nën moshën  
Loku. Akuzë  
"VV"-së ka  
drejtor Ar-  
tjetër shtypi.  
a ardhur tek  
uar se është  
hapësirave të  
Sipas Gurit,  
n 18-veçare  
rmosin peti-  
2 të Ligjit të  
në Repub-  
janë fëmijë  
mshën 18-  
st, i bëj apel  
të mos i ma-  
ëllime elek-  
i. Ndërkaq,  
ategorikisht  
pa peticionit  
shkuar të  
e vërtetë se  
peticionit të

nxënësve. Akuzat e partisë në  
pushtet janë krejtësisht të pabaza.  
Ajo çka e kemi thënë dhe do ta  
vazhdojmë ta themi është se i  
mbështesim fuqishëm kërkesat e  
drejta të këtyre nxënësve", ka thek-  
suar Basri Kodra, kryetar i "VV"-së  
të Kaçanikut. Akuzat e PDK-së i  
kanë mohuar edhe nxënësit. "Nuk  
kemi kurrfarë lidhje me partitë.  
Është nismë jona me kërkesa plotë-  
sisht të drejta", i ka thënë KD-së  
Alma Dema, nxënëse e klasës XI të  
gjimnazit "Skënderbeu" të  
Kaçanikut. Ajo dhe 2-3 nxënës të  
tjerë janë parë duke mbledhur nën-  
shkrime në një pikë në qendër të  
qytetit, të mërkurën në mesditë.  
"Deri tashti i kemi mbledhur rreth  
900 nënshkrime, ndërsa firmosja e  
peticionit do të vazhdojë edhe në  
ditët në vijim", ka thënë Dema. Ajo  
ka pohuar të ketë dëgjuar se nisma  
e tyre është mbështetur nga 2 parti  
opozitare. "Po e përsëris se nuk  
kemi lidhje me partitë, por më duhet  
të them se e vlerësojmë mbështetjen  
që na është dhënë nga LVV-ja dhe  
AAK-ja", ka deklaruar Dema.

# Shoqëria civile e Lipjanit rekomandon ndryshim të statutit komunal

Arian Duriqi

LIPIAN, 6 QERSHOR – Komuna e Lipjanit është vënë sërish nën llupën e shoqërisë civile për faktin se po vazhdon të shkelë statutin, komunal dhe këtë që nga mbledhja e dytë e KK-së, e mbajtur më 10 shkurt 2010. Atëkohë, me rastin e miratimit të emërimeve të drejtorëve të propozuar nga kreu komunal, Shukri Buja, ishte shkelur neni 47 i statutit të Komunës së Lipjanit, i miratuar më 26 shtator 2008. Me këtë statut parashiheshin 10 drejtori, ndërsa më 2010 ishin miratuar 13 drejtori, apo 3 më shumë seç parashiheshin në aktin më i lartë aktual. Dhe, shoqëria civile në këtë komunë që merret me monitorimin e KK-së, përkatësisht Asociacioni Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR), nëpërmjet raportit të fundit monitorues ka rekomanduar autoritetet komunale për ndryshim emergjent të statutit komunal. "KK i Lipjanit duhet së shpejti të bëjë ndryshime në statutin komunal në nenin 47, për t'u përshatur me realitetin e krijuar me ç'rast më 2010 drejtoritë komunale ishin rritur nga 10 në 13 sish. Gjithashtu, KK i Lipjanit duhet të harmonizojë edhe vendimet me ligjet në fuqi", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR. Në të vërtetë, ka pasur përpjekje të mëhershme nga Kuvendi për harmonizimin e statutit me gjendjen faktike dhe kjo pati ndodhur në seancën e gjashtë të 8 korrikut 2010, por kjo përpjekje pati dështuar për mungesë të 2/3 e votave të këshilltarëve të KK-së. Për më tepër, udhëheqësi i YAHR-së, Krasniqi, duke iu referuar raportit të sapodalë të organizatës që drejton ka shtuar po ashtu se kjo OJQ gjatë monitorimit të aktiviteteve të këshilltarëve në seanca të KK ka konstatuar se mungon edhe një efikasitet i një pjese të opozitës për artikullimin e interesave të qytetarëve. "Dhe, është për t'u çuditur edhe pse shoqëria civile iu drejtohet për përkrahje dhe për zgjidhje të problemeve konkrete, prapëseprapë pjesa e madhe e opozitës është e heshtur", ka thënë ai. Krasniqi nuk ka harruar po ashtu të rikujtonte në raport se këshilltarët e KK-së në seancën 26-



**Asociacioni Rinor për të Drejtat e Njeriut (YAHR), nëpërmjet raportit të fundit monitorues ka rekomanduar autoritetet komunale për ndryshim emergjent të statutit komunal**

të të 30 prillit 2012 kanë bërë shkelje ligjore edhe lidhur me shndërrimin e aseteve komunale në këtë rast të laptopëve në pronësi personale të këshilltarëve të Lipjanit. "Ky vendim është në kundërshtim me ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik neni 6, neni 7.1, neni 7.5, neni 7.7 dhe neni 7.8. Një veprim i tillë është i ndaluar për zyrtarët e lartë në bazë të dispozitës ligjore të këtij ligji në fjalë", ka thënë ai. Ndërkohë që, për të gjitha këto që u thanë e nuk u thanë nga raporti monitorues i YAHR-it, ka sqarimin e tij Lulzim Rustemi, kryesues i KK-së. Sa i përket ndryshimit të aktit më të lartë komunal, ai thotë se nevoja për ta ndryshuar atë ekziston dhe do të ketë përpjekje të sërishme për këtë punë, mirëpo shpreh dyshimet e tij se opozita do ta bllokojë këtë hesap. "Që atëherë Komuna ka pasur nevojë për rritje drejtorish drejt një pune dhe efikasiteti më të madh. Kjo edhe është bërë me miratim të KK-së, mirëpo opozita pati bllokuar ndryshimin e statutit komunal. Ne do ta vendosim sërish shumë shpejt në votim atë, por nuk dihet në qoftë se do të marrim mbështetjen e opozitës, sepse aty nevojiten 2/3 e votave të këshilltarëve", ka thënë ai.